



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 5/167
Datë: 13/12/2022

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur më 12.12.2022, mori vendim të shpallë:

KONKURS
Për ndarjen e bursave universitare për vitin akademik 2022/23

I. Kushtet e përgjithshme

1. Bursa universitare ndahen për studentët e nivelit të studimeve themelore (baçelor).
2. Të drejtë aplikimi për bursë universitare kanë studentët të cilët i plotësojnë këto kushte:
 - 2.1. Të jenë studentë të rregullt të fakulteteve të Universitetit të Prishtinës;
 - 2.2. Të jenë studentë të vitit të dytë e më lartë;
 - 2.3. Të mos kenë vit të përsëritur të studimeve;
 - 2.4. T'i kenë dhënë të gjitha provimet e parapara për vitin përkatës të studimeve në afatin e shtatorit të vitit akademik 2021/22;
 - 2.5. Të kenë notë mesatare të studimeve më së paku 9.00 (nëntë pikë zero).
3. Përjashtimisht nga pika 2.5, studentët e Fakultetit të Ndërtimtarisë, të Fakultetit të Arkitekturës, të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, si dhe studentët e Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, Departamenti i Matematikës dhe Departamenti i Fizikës, mund të aplikojnë edhe me notë mesatare më të ulët, por jo më pak se 8 (tetë).
4. Studentëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret e sipërshënuara, shërbimi i studentëve në njësinë akademike përkatëse nuk do t'ua verifikojë në SEMS fletëparaqitjen e cila ua mundëson aplikimin për bursë.
5. Studentët të cilët në vitin akademik 2021/22 kanë pasur statusin e studentit me korrespondencë, nuk kanë të drejtë aplikimi për bursë universitare për vitin akademik 2022/23.

II. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

1. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika një (I) e këtij konkursi, aplikimin duhet të bëjnë përmes platformës elektronike SEMS në linkun: studenti.uni-pr.edu
2. Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:
 - 2.1 Kërkesa për aplikim (Fletë aplikacioni) i cila shkarkohet pas aplikimit online përmes SEMS.

3. Studenti obligohet që Fletë aplikacionin ta printoj dhe ta dorëzoj në shërbimin e studentëve të fakultetit përkatës, si dëshmi që ka aplikuar brenda afatit të paraparë të konkursit.
4. Fakultetet janë të obliguara që në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë konkurs t'i përgatisin listat e studentëve të cilët i plotësojnë kriteret për fitimin e bursës universitare për miratim nga Këshilli Drejtues i UP-së.
5. Përgjegjësinë për saktësinë e të dhënave do ta bartin dekanët e njësive akademike.
6. Bursat universitare për vitin akademik 2022/23 nga rezultatet e arritura të vitit akademik 2021/22, do t'u ndahen studentëve të nivelit baçelor, të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë konkurs, ndërsa lartësia e bursës do të përcaktohet me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues.
7. Nëse gjatë aplikimit paraqiten probleme eventuale teknike, të kontaktohet zyrtari i TI-së në njësinë akademike përkatëse.

III. Afati i aplikimit

1. Aplikimi në linkun studenti.uni-pr.edu hapet prej datës 14.12.2022 deri me datë 28.12.2022, në orën 15:30.
2. Ditën e parë të konkursit, me datë 14.12.2022, aplikimi elektronik do të funksionalizohet nga ora 13:00.

IV. Afati i ankesave

1. Studentët të cilët konsiderojnë se kanë pasur të drejtë përfitimi të bursës universitare dhe nuk janë përfshirë në listën e studentëve përfitues të bursës, kanë të drejtë ankesë në afat prej dyzet e tetë (48) orësh pas ditës së publikimit të listave.
2. Ankesat dorëzohen në zyrën e arkivit të UP-së (nr. 18), në ndërtesën e Rektoratit të UP-së.
3. Ankesat e dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

V. Publikimi

Vendimi do të publikohet në tabelat e shpalljeve dhe ueb faqet e fakulteteve, si dhe në ueb faqen e Universitetit: www.uni-pr.edu.

